



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr. 70**

**22 qershor**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 59/2012 datë 24.5.2012	Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e kulturës.....	3311
Ligj nr. 60/2012 datë 24.5.2012	Për një ndryshim në ligjin nr. 9861, datë 24.1.2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”.....	3315
Vendim i Kuvendit nr. 22/2012 datë 24.5.2012	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar.....	3316
Rezolutë e Kuvendit datë 24.5.2012	Për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2011.....	3316
Rezolutë e Kuvendit datë 31.5.2012	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për vitin 2011.....	3317
Dekret nr. 7500 datë 31.5.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3318
Vendim i KM nr. 348, datë 23.5.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Agron Aliaj.....	3319
Urdhër i MD nr. 248, datë 7.6.2012	Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e mënyrave, procedurave dhe kushteve për përdorimin e sistemit elektronik “one stop shop-sistemi i noterisë”.....	3320
Vendim i GJK nr. 36, datë 5.6.2012	Me objekt shfuqizimin, si antikushtetues, të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 324, datë 16.06.2011; të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 1705, datë 28.10.2008, si dhe të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 1389, datë 19.02.2008.....	3328
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Misir Orhan Tare.....	3334

**LIGJ**  
**Nr. 59/2012**

**PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EUROPIAN PËR  
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E KULTURËS**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e kulturës.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.5.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7541, datë 15.6.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI**  
**NDËRMJET BASHKIMIT EUROPIAN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR  
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E KULTURËS**

Komisioni Europian, më poshtë i quajtur “Komisioni”, në emër të Bashkimit Europian nga njëra anë, dhe Republika e Shqipërisë, më poshtë e quajtur “Shqipëri” nga ana tjetër, ndërsa:

1. Marrëveshja kuadër e datës 22 nëntor 2004, ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë<sup>1</sup> vendos parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e Komunitetit, duke i lënë Komisionit dhe autoriteteve kompetente të Shqipërisë për të përcaktuar termat dhe kushtet specifike, duke përfshirë kontributin financiar, në lidhje me këtë pjesëmarrje në çdo program të veçantë;

2. Programi i kulturës u themelua me vendim nr. 1855/2006/EC<sup>2</sup> të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 12 dhjetor 2006, kanë rënë dakord si më poshtë:

<sup>1</sup> OJL 192, 22.7. 2005, p.2

<sup>2</sup> OJL 372,27.12.2006, p.



## Neni 1

Shqipëria merr pjesë në programin e kulturës (më poshtë e quajtur “programi”), në pajtim me kushtet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër të datës 22 nëntor 2004, ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë, vendos parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e Komunitetit dhe sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në anekset I, II dhe III të këtij memorandum mirëkuptimi.

## Neni 2

Ky memorandum mirëkuptimi zbatohet gjatë kohëzgjatjes së programit. Megjithatë, nëse Bashkimi Europian vendos të zgjasë kohëzgjatjen e programit pa ndonjë ndryshim thelbësor brenda programit, ky memorandum do të zgjatej përkatësisht dhe automatikisht, nëse asnjë palë nuk e denoncon atë brenda një muaji pas vendimit të zgjatjes.

Anekset I, II dhe III përbëjnë një pjesë integrale të këtij memorandum mirëkuptimi.

Ky memorandum mirëkuptimi mund të ndryshohet vetëm me shkrim, me pëlqimin e përbashkët të palëve.

Ky memorandum mirëkuptimi hyn në fuqi në datën e njoftimit me shkrim, nëpërmjet të cilit Shqipëria njofton Komisionin nëpërmjet kanaleve diplomatike që kërkesat e saj të brendshme ligjore për hyrjen e tij në fuqi janë përmbushur. Deri në hyrjen e tij në fuqi, ky memorandum mirëkuptimi do të zbatohet provizorisht, duke filluar nga viti buxhetor 2012.

Në rast se Shqipëria njofton Komisionin që ajo nuk do ta ratifikojë memorandumun e mirëkuptimit të nënshkruar, zbatimi i tij provizor përfundon nga viti buxhetor që pason këtë njoftim. Njoftimi që përfundon zbatimin provizor nuk i prek detyrimet e palëve në lidhje me projektet dhe aktivitetet e financuara sipas buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Europian të vitit të njoftimit dhe as pagesën nga Shqipëria të kontributit për vitin e njoftimit.

## ANEKSI I

### TERMAT DHE KUSHTET PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E KULTURËS

1. Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë memorandum mirëkuptimi, Shqipëria do të marrë pjesë në aktivitetet e programit të kulturës (këtu e quajtur “programi”) në pajtim me objektivat, kriteret, procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 1855/2006/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 12 dhjetor 2006, themelues të këtij programi të Bashkimit Europian.

2. Për pjesëmarrjen në këtë program, Shqipëria do t'i paguajë çdo vit një kontribut buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Europian në pajtim me modalitetet e përshkruara në aneksin II. Nëse është e nevojshme për të marrë parasysh zhvillimet e programit ose evoluimin e kapacitetit thithës të Shqipërisë, ky kontribut mund të përshtatet me shkrim me pëlqimin e përbashkët të palëve, për të mënjanuar disbalancën buxhetore në zbatimin e programit.

3. Termat dhe kushtet për paraqitjen, vlerësimin dhe përzgjedhjen e aplikimeve në lidhje me institucionet, organizatat dhe individët e përshtatshëm të Shqipërisë do të jenë të njëjta si ato që zbatohen për institucionet, organizatat dhe individët e përshtatshëm të Bashkimit Europian.

4. Me qëllim sigurimin e dimensionit të Bashkimit Europian të programit, për të qenë i përshtatshëm për mbështetje financiare, projektet e bashkëpunimit duhet të përfshijnë të paktën një bashkorganizator nga një prej shteteve anëtare të Bashkimit Europian.

5. Shuma maksimale e mbështetjes financiare për aktivitetet e pikës së kontaktit kulturor të Shqipërisë nuk i kalon 50% të buxhetit të plotë për aktivitetet e saj dhe nuk kalon dy të tretat e kontributit financiar të vendit të specifikuar në pikën 1 të aneksit II.

6. Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe të Gjykatës së Auditëve të Bashkimit European në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në program monitorohet vazhdimisht mbi bazë partneriteti, duke përfshirë Komisionin dhe Shqipërinë. Shqipëria i paraqet Komisionit raporte përkatëse dhe merr pjesë në aktivitete të tjera specifike të ofruara nga Bashkimi European në këtë kontekst.

Rregullat në lidhje me kontrollin financiar, kompensimin dhe masat e tjera kundër mashtrimit janë parashikuar në aneksin III.

7. Gjuha që përdoret në të gjitha llojet e kontakteve me Komisionin, në lidhje me procesin e aplikimit, kontratat, raportet që duhet të paraqiten dhe masat administrative për programin do të jetë një prej gjuhëve zyrtare të Bashkimit European.

8. Bashkimi European dhe Shqipëria mund të përfundojnë aktivitetet sipas këtij memorandumi mirëkuptimi në çdo kohë pas një njoftimi me shkrim dymbëdhjetëmujor. Projektet dhe aktivitetet në vazhdim në momentin e ndërprerjes, vazhdojnë deri në përfundim të tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë memorandum mirëkuptimi, si dhe masat kontraktuale që zbatohen për këto projekte dhe aktivitetet dhe dispozitat e aneksit III.

## ANEKSI II KONTRIBUTI FINANCIAR I SHQIPËRISË PËR PROGRAMIN E KULTURËS

1. Kontributi vjetor financiar që duhet të paguhet nga Shqipëria për buxhetin e Bashkimit European për të marrë pjesë në programin e kulturës do të jetë 41 000 euro.

2. Shqipëria do të financojë kontributin e përmendur më sipër pjesërisht nga Buxheti i Shtetit të Shqipërisë dhe pjesërisht nga fondet e paraadërimit të Shqipërisë, në pajtim me procedurat vjetore të programimit brenda kuadrit të Rregullores së Këshillit (EC) 1085/2006, të datës 17 korrik 2006<sup>1</sup>. Fondet e kërkuara të paraadërimit do t'i transferohen Shqipërisë çdo vit në pajtim me një marrëveshje financiare, si një rimbursim i një pjese të kontributit vjetor financiar, që faktikisht është paguar në përgjigje të ftesave vjetore për fonde nga Komisioni.

3. Grafiku provizor në lidhje me fondet e paraadërimit është si më poshtë:

<b>Viti 2012 (IPA 2009)</b>	<b>Viti 2013 (IPA 2011 ose 2012)</b>
37 000	35 000

Pjesa e mbetur e kontributit të Shqipërisë do të mbulohet nga Buxheti i Shtetit të Shqipërisë.

Nëse këto shuma treguese nuk konfirmohen në procedurën vjetore të programimit të paraadërimit, Buxheti i Shtetit të Shqipërisë do të mbulojë diferencën ndërmjet kontributit të plotë financiar të treguar në pikën 1 më sipër dhe mbështetjes së dhënë për paraadërimitin.

4. Rregullimi financiar i zbatueshëm për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit European zbatohet, kryesisht për menaxhimin e kontributit të Shqipërisë.

Shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e qëndrimit të shkaktuara nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë, për qëllimin e marrjes pjesë si vëzhgues, në punën e komitetit të përmendur në nenin 9 të vendimit nr. 1855/2006/EC të Parlamentit European dhe të Këshillit të datës 12 dhjetor 2006 ose mbledhje të tjera në lidhje me zbatimin e programit, rimbursohen nga Komisioni mbi të njëjtën bazë dhe në pajtim me procedurat faktikisht në fuqi për përfaqësuesit dhe ekspertët e shteteve anëtare të Bashkimit European.

5. Pas hyrjes në fuqi të këtij memorandumi mirëkuptimi dhe me fillimin e çdo viti pasues, Komisioni do t'i dërgojë Shqipërisë një ftesë për fonde që përputhen me kontributin e saj në buxhetin e programit sipas këtij memorandumi mirëkuptimi.

<sup>1</sup> OJL 210, 31.7.2006, p. 82



Ky kontribut shprehet në euro dhe paguhet në një llogari bankare të Komisionit në euro.

Shqipëria do të paguajë kontributin e saj deri më 1 prill, me kusht që ftesa për fondet të jetë dërguar nga Komisioni para datës 1 mars ose jo më vonë se një muaj pas ftesës për fonde, nëse dërgohet më vonë.

Çdo vonesë në pagesën e kontributit shkakton pagesën e interesit nga Shqipëria për shumën e mbetur nga data e kërkueshme. Norma e interesit përputhet me normën që zbatohet nga Banka Qendrore Europiane për veprimet e saj kryesore të rifinancimit, siç publikohet në serinë C të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Europian, në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajit në të cilin bie data e kërkueshme e shtuar me 3.5 pikë përqindjeje.

### ANEKSI III

#### KONTROLI FINANCIAR. KOMPENSIMI DHE MASA TË TJERA KUNDËR MASHTRIMIT

##### I. KONTROLLET DHE MASAT KUNDËR MASHTRIMIT NGA BASHKIMI EUROPIAN

1. Në pajtim me rregulloret financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian dhe me rregullat e tjera të përmendura në këtë memorandum mirëkuptimi, kontratat e lidhura me përfutjesit e programit të themeluar në Shqipëri, parashikojnë auditivet financiare dhe të tjera që duhet të kryhen herë pas here në mjediset e përfutjesve dhe të nënkontraktorëve të tyre nga agjentët e Komisionit ose nga personat e autorizuar nga Komisioni.

2. Agjentët e Komisionit dhe personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni kanë aksesin e duhur në vendet, punët dhe dokumentet dhe në të gjithë informacionin e kërkuar, me qëllim që të kryhen këto audite, duke përfshirë aksesin në formë elektronike. E drejta e aksesit do të jetë e përcaktuar shprehimisht në kontratat e lidhura për të zbatuar instrumentet e përmendura në këtë memorandum. Gjykata Europiane e Auditëve ka të njëjtat të drejta si edhe Komisioni.

3. Brenda kuadrit të këtij memorandum, Komisioni/OLAF (Zyra Europiane Kundër Mashtrimit) autorizohet të kryejë kontrole dhe inspektime në vend në territorin e Shqipërisë, në pajtim me dispozitat procedurale të rregullores së Këshillit (Euratom, EC) nr. 2185/96, të datës 11 nëntor 1996<sup>1</sup>.

Këto kontrole dhe inspektime përgatiten dhe zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente të caktuara nga Shqipëria, të cilat njoftohen në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontroleve dhe inspektimeve, në mënyrë që ato të japin të gjithë ndihmën e kërkuar.

Nëse autoritetet përkatëse të Shqipërisë e dëshirojnë këtë, kontrollet dhe inspektimet në vend mund të kryhen së bashku me to.

Nëse pjesëmarrësit në program nuk lejojnë kontrollin ose inspektimin në vend, autoritetet e Shqipërisë, duke vepruar në pajtim me rregullat e brendshme, u japin inspektorëve të Komisionit/OLAF atë ndihmë që atyre u duhet për t'u mundësuar atyre të përmbushin detyrat e tyre në kryerjen e kontrollit ose inspektimit në vend.

Komisioni/OLAF u raporton autoriteteve të Shqipërisë, sa më shpejt të jetë e mundur, për çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi të vënë re gjatë kontrollit ose inspektimit në vend. Në çdo rast, Komisioni/OLAF i kërkohet të informojë autoritetin e lartpërmendur në lidhje me rezultatin e këtyre kontroleve dhe inspektimeve.

##### II. INFORMACIONI DHE KONSULTIMI

1. Për qëllimin e zbatimit të duhur të këtij aneksi, autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe autoritetet e Bashkimit Europian shkëmbejnë rregullisht informacion dhe, me kërkesë të një prej palëve, zhvillon konsultime.

2. Autoritetet kompetente të Shqipërisë informojnë Komisionin pa vonesë për çdo fakt ose

<sup>1</sup> OJL 292 15.11.1996, p2

dyschim që është vënë re në lidhje me një parregullsi, për sa i takon lidhjes dhe zbatimit të kontratave të lidhura në zbatim të instrumenteve të përmendura në këtë memorandum.

### III. MASAT ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT

Pa cenuar zbatimin e ligjit penal të Shqipërisë, masat administrative dhe gjobat mund të vendosen nga Komisioni në pajtim me rregulloren financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian.

### IV. KOMPENSIMI

Vendimet e marra nga Komisioni brenda objektivit të këtij memorandum, që vendos një detyrim monetar për personat e ndryshëm nga shtetet, janë të ekzekutueshëm në Shqipëri. Ekzekutimi rregullohet nga rregullat e procedurës civile në fuqi në Shqipëri. Urdhri për ekzekutimin i bashkëngjitet vendimit pa formalitet tjetër, përveç verifikimit të vërtetësisë së vendimit, nga autoriteti i brendshëm që Qeveria e Shqipërisë do të caktojë për këtë qëllim dhe ia bën të ditur Komisionit. Pasi të jenë përmbushur këto formalitete për zbatim nga Komisioni, ky i fundit mund të vazhdojë me ekzekutimin në pajtim me ligjin e brendshëm, duke e sjellë çështjen drejtpërdrejt tek autoriteti kompetent. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit i nënshtrohet kontrollit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian.

Vendimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Europian, në pajtim me një dispozitë arbitrazhi në një kontratë brenda objektivit të këtij memorandum, janë të ekzekutueshme në të njëjtat kushte.

### V. KOMUNIKIMI I DREJTPËRDREJTË

Komisioni komunikon drejtpërdrejt me pjesëmarrësit në programin e themeluar në Shqipëri dhe me nënkontraktorët e tyre. Këta mund t'i paraqesin drejtpërdrejt Komisionit informacionin dhe dokumentacionin e duhur, i cili iu kërkohet ta paraqesin mbi bazën e instrumenteve të përmendura në këtë memorandum dhe të kontratave të lidhura për zbatimin e tyre.

## LIGJ

Nr. 60/2012

### **PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9861, DATË 24.1.2008 “PËR KONTROLLIN DHE MBIKËQYRJEN E KUFIRIT SHTETËROR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

#### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### VENDOSI:

Në ligjin nr. 9861, datë 24.1.2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Neni 53 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 53  
**Shfuqizime**

Nenet 1, 2, 4 dhe 5 të ligjit nr. 8771, datë 19.4.2001 “Për kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr. 8772, datë 19.4.2001 “Për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.”.



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.5.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7542, datë 15.6.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**VENDIM  
Nr. 22/2012**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 3, DATË 16.9.2009 “PËR  
CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1 dhe 21 pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, në pikën I bëhen këto ndryshime:

I. Deputetët Ramiz Çobaj dhe Arben Isaraj largohen nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe caktohen anëtarë në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.

II. Deputeti Edison Konomi caktohet anëtar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)**

Miratuar në datën 24.5.2012

**REZOLUTË  
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE  
PËR VITIN 2011**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke vlerësuar misionin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për sigurimin dhe kompensimin e depozitave të qytetarëve, të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë;

Duke njohur vizionin e institucionit për të kontribuar në ruajtjen dhe forcimin e qëndrueshmërisë së sistemit bankar, nëpërmjet rritjes së efektivitetit të skemës së sigurimit të depozitave;

Duke njohur kuadrin ligjor dhe parimet bazë, mbi të cilat mbështetet veprimtaria e institucionit;

Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare,

**Konstaton se gjatë vitit 2011 Agjencia e Sigurimit të Depozitave:**

- Ka respektuar kërkesat e kuadrit ligjor e rregullator në fushën e sigurimit të depozitave;
- Ka mbikëqyrur në vijimësi procesin e derdhjes nga bankat e nivelit të dytë të primit vjetor të sigurimit, duke ndikuar në rritjen e të ardhurave nga ky burim;
- Ka investuar fondet, me efektivitet dhe në përputhje me standardet e menaxhimit të riskut, në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare, si dhe letra me vlerë në monedhë të huaj të qeverive, bankave qendrore dhe institucioneve financiare ndërkombëtare të vendeve të tjera;
- Ka administruar me efektivitet mjetet financiare të institucionit, duke rritur fitimin nga kjo veprimtari dhe kapitalin e përgjithshëm;
- Ka kontribuar në rritjen e depozitave të qytetarëve në sistemin bankar, si dhe u ka dhënë përparësi depozitave në lekë, krahasuar me ato në valutë;
- Ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me Bankën e Shqipërisë dhe me institucionet ndërkombëtare në fushën e sigurimit të depozitave.

**Kuvendi kërkon që, për vitin 2012, Agjencia e Sigurimit të Depozitave të thellojë më tej përvojën në këto drejtime:**

- Modernizimin e kuadrit rregullator të institucionit në drejtim të rritjes së efektivitetit të sigurimit të depozitave, në përputhje me parimet bazë ndërkombëtare, si dhe direktivën europiane në këtë fushë;
- Automatizimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit për sistemin e raportimit dhe vlerësimit të primit të sigurimit të depozitave;
- Rritjen e nivelit profesional të stafit të institucionit;
- Rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe të besueshmërisë së tij në sistemin e sigurimit të depozitave;
- Rritjen e bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe institucionet financiare në vend, si dhe me organizmat ndërkombëtarë të specializuar të fushës.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

24 maj 2012

**REZOLUTË  
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE  
TELEVIZIONIT PËR VITIN 2011**

**Kuvendi i Shqipërisë vëren se:**

- KKRT-ja ka arritur të dukshme në zbatimin e kërkesave të Kuvendit të Shqipërisë, të shprehura në rezolutën e vlerësimit të punës së këtij institucioni në vitin 2011.
- Veprimtaria e KKRT-së është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

**Kuvendi vlerëson se:**





- KKRT-ja, gjatë vitit 2011, ka bërë një punë intensive për hartimin e “Strategjisë së kalimit nga sistemi i transmetimit analog në atë numerik”, si dhe në procesin e hartimit të projektligjit “Për transmetimet me zë dhe/ose me zë e figurë në Republikën e Shqipërisë”.

- Ka realizuar me sukses monitorimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet vendore të majit, si dhe monitorimin e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave.

- Ka përqendruar punën e saj në rritjen e efikasitetit ndaj luftës kundër piraterisë, duke ushtruar kontrolle të vazhdueshme, dhe ka vendosur sanksione ndaj shkelësve të ligjit, duke rritur në këtë mënyrë garancitë për një konkurrencë të ndershme.

**Kuvendi kërkon nga KKRT-ja:**

- Ndërhyrje më efikase në rastet e piraterisë radiotelevizive dhe të shkeljes së të drejtave të autorit.

- Nxitjen e llojshmërisë së tematikave të programacioneve dhe standardeve të kërkuara.

- Forcimin e kapaciteteve teknike dhe monitoruese.

- Konsolidim të mëtejshëm të bashkëpunimit me organet e tjera mbështetëse e zbatuese të ligjit.

- Përshtatjen e strukturës ekzistuese me kërkesat e ligjit të ri, pas miratimit të tij nga Kuvendi.

- Rritjen e standardeve të etikës dhe funksionimit me efikasitet të Këshillit të Etikës.

- Siç është theksuar edhe në rezolutën e vitit të kaluar, marrjen e masave për vjeljen e detyrimeve nga subjektet debitore të taksave apo gjobave.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

31 maj 2012

**DEKRET**

**Nr. 7500, datë 31.5.2012**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, 10 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Bardhyl Esat Kamberi
2. Panagiotis Matheos Tzelis
3. Ufuk Öztekin Uyanil
4. Musa Kenan Koçak
5. Elena Aleksandr Kita (Ptiçkina)
6. Marina Sergej Doko (Skopova)
7. Ludmilla Kostandin Muçi (Goga)
8. Dritëro Nazim Kaba
9. Mahabat Alisher Inaltekin (Kochorbaeva)
10. Süleyman Birol Inaltekin

11. Fatih Dilaver Gülebakan
12. Irina Aleksandr Matvejeva
13. Liubov Aleksandr Hoxha (Ermolina)
14. Osman Shaban Rushiti
15. Arzu Kanber İşik
16. Ganimete Halil Katroshi (Demaj)
17. Mirela Esat Oktrova
18. Ahmet Halil Yilmaz
19. Musli Alirabi Abdija
20. Hatice Mustafa Ali Hoxha (Şan)
21. Mustafa Göktuğ Tevfik İlhan
22. Bouda Driss Alami Kouiyes
23. Shukri Hilmi Bajrami
24. Nexhat Shukri Bajrami
25. Vedat Zeqir Ademi
26. Aldo Tommaso Gaeta
27. Antigona Nebi Gashi (Hoxhaj)
28. Muzafer Qerim Xhemaili
29. Fahri Bajram Kuçi (Tarakaj)
30. Fatime Hamit Nako (Islami)
31. Melda Bedri Pencabligil
32. Ömer Karahan Mehmet Seyhan Pencabligil
33. Zeynep Karia Mehmet Seyhan Pencabligil
34. Robert Wright, Jr. Robert Wright Provost
35. Pamala (Pamela) Denice Ralph Provost (Beltran)
36. Wesley Watson Robert Wright Provost
37. Robert Beltran Robert Wright Provost
38. Winston Elliot Robert Wright Provost
39. Nuriye Muarem Daci (Dalipi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Bamir Topi**

**VENDIM**

**Nr. 348, datë 23.5.2012**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË  
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT  
TË Z. AGRON ALIAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në zërin “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të zotit Agron Aliaj.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**URDHËR**

**Nr. 248, datë 7.6.2012**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRAVE,  
PROCEDURAVE DHE KUSHTEVE PËR PËRDORIMIN E SISTEMIT ELEKTRONIK  
“ONE STOP SHOP-SISTEMI I NOTERISË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për përcaktimin e mënyrave, procedurave dhe kushteve për përdorimin e sistemit elektronik “One Stop Shop-Sistemi i noterisë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen noterët dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri, si dhe njoftimin e tij pranë të gjithë noterëve dhe zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që përfshihen brenda fushës së veprimit të kësaj rregulloreje.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË  
Eduard Halimi

**RREGULLORE**  
PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRAVE, PROCEDURAVE DHE KUSHTEVE PËR PËRDORIMIN  
E SISTEMIT ELEKTRONIK “ONE STOP SHOP-SISTEMI I NOTERISË”

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1  
**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrave, procedurave dhe kushteve për përdorimin e sistemit elektronik “One Stop Shop-Sistemi i noterisë”, duke parashikuar të drejtat dhe detyrimet e përdoruesve, operatorit të llogarisë, operatorit të ZRPP-së, administratorit të sistemit, raportuesit dhe punonjësve të ZVRPP-ve, të ngarkuar me ofrimin e shërbimeve të kërkuara *on-line* nga noterët.

Neni 2  
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është ofrimi i shërbimit të kontrollit zyrtar *on-line* të pasurive të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to, duke siguruar për noterin një informacion të përditësuar të gjendjes juridike të pronësisë së pasurisë së paluajtshme, me qëllim redaktimin e akteve noteriale për tjetërsimin ose njohjen e pronësisë mbi sendet e paluajtshme ose të një të drejtë reale mbi to.

Neni 3  
**Fusha e veprimit**

Kjo rregullore i shtrin efektet vetëm për zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë dhe Durrës, si dhe për noterët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre, në territorin që mbulojnë këto dy zyra të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Neni 4  
**Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, si dhe ligjin nr. 7889, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar.

2. Termat specifikë të përdorur në këtë rregullore, kanë këtë kuptim:

a) “Sistemi OSS” është sistemi elektronik “One Stop Shop-Sistemi i noterisë”, nëpërmjet të cilit bëhet e mundur ndërlidhja *on-line* e noterëve me ZRPP-në, me qëllim sigurimin e një informacioni të përditësuar të gjendjes juridike të pronësisë së pasurisë së paluajtshme dhe paraqitjes *on-line* të kërkesës për regjistrimin e aktit noterial dhe përfitimin e shërbimit të regjistrimit në të njëjtën mënyrë.

b) “Logim” është hyrja nga noteri në sistemin OSS, për të pasur akses në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme.

c) “Operator llogarie” është punonjësi i ZRPP-së, i caktuar për përditësimin e llogarisë së noterit në sistemin OSS, sipas procedurave të përcaktuara në dispozitat e kësaj rregulloreje.

ç) “Operator i ZRPP-së” është punonjësi i ZRPP-së, i caktuar për ndjekjen e procesit të trajtimit të kërkesave të bëra *on-line* nga noterët, sipas procedurave të përcaktuara në dispozitat e kësaj rregulloreje.



d) “Administrator i sistemit” është punonjësi i ZRPP-së, i ngarkuar për mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit dhe që ka autoritetin e plotë për të shtuar dhe për të hequr çdo të dhënë nga sistemi, e cila nuk është më e nevojshme.

dh) “Raportues” është personi i ngarkuar për të analizuar dhe vlerësuar, nëpërmjet përgatitjes dhe dorëzimit të raporteve me shkrim, mbi ecurinë e sistemit OSS, si dhe efikasitetin dhe efektshmërisë së veprimeve të kryera nga ZRPP-ja për ofrimin e shërbimit të trajtimit të kërkesave për regjistrim të paraqitura nga noterët.

e) “ZRPP-ja” është Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

## KREU II SISTEMI OSS

### Neni 5 Qëllimi i sistemit OSS

1. Sistemi OSS është sistem i posaçëm, që i siguron noterëve lidhjen *on-line* nëpërmjet një ndërfaqeje *web* me regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme, me qëllim verifikimin nga noteri të gjendjes juridike të pasurisë së paluajtshme, nëpërmjet një imazhi të saj të shfaqur *on-line*.

2. ZRPP-ja ofron shërbimin e “konsultimit të kartelës dhe të dhënave të tjera për pasurinë e paluajtshme” dhe shërbimin “dhënie të informacionit zyrtar të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për individët dhe institucionet”, për noterët, nëpërmjet sistemit OSS.

3. Sistemi OSS, i ofron strukturave përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë, Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive, si dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, mundësinë që nëpërmjet raporteve dhe analizave të detajuara të monitorojnë mënyrën e realizimit të detyrave, të inspektojnë respektimin e procedurave ligjore dhe të bëjnë një organizim dhe menaxhim më të mirë të punës.

### Neni 6 Regjistrimi i noterëve në sistem

1. Çdo person që ushtron veprimtarinë si noter, bazuar në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, fillimisht duhet të regjistrohet si përdorues i sistemit OSS.

2. Noteri, për regjistrimin e tij si përdorues i sistemit OSS, duhet të depozitojë pranë administratorit të sistemit, së bashku me kërkesën për regjistrimin si përdorues, këto dokumente:

a) kopje të njëzuar me origjinalin të licencës për ushtrimin e profesionit të noterit;

b) kopje të regjistrimit të tij në përputhje me ligjin, si dhe numrin e NIPT-it;

c) fotokopje të kartës së identitetit;

ç) formularin tip të regjistrimit si përdorues, sipas modelit të paraqitur në aneksin 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, të plotësuar dhe të nënshkruar rregullisht;

d) nënshkrimin e deklaratës se është njohur dhe do të respektojë kushtet e përdorimit të sistemit OSS.

3. Administratori i sistemit, pasi verifikon dokumentacionin e paraqitur sipas paragrafit 2 të këtij neni, pajis noterin me:

a) *user-name*-in si përdorues i sistemit OSS;

b) fjalëkalimin për hyrjen e sigurt në sistem, që është standard **PASSWORD**. Fjalëkalimi, pasi përdoruesi hyn në sistem duhet të ndërrohet. Sistemi kërkon vendosjen e një fjalëkalimi të ri, ruajtja e fshehtësisë së të cilit është detyrë e noterit.

#### Neni 7

### **Hapja e llogarisë së noterit si përdorues i sistemit**

1. Pas regjistrimit si përdorues, noteri mund të ketë akses në sistemin OSS, për të marrë shërbime nga ZRPP-ja, për pasuritë e paluajtshme, por duhet të vërtetojë kryerjen e një pagese paradhënie në llogarinë ekonomike të të ardhurave të Degës së Thesarit “Mjete në ruajtje të noterit për ZRPP-në”, në bazë të faturës për arkëtim që do të tërheqë nga ZRPP-ja, llogari, e cila do të hapet nga noteri dhe që përdoret vetëm për qëllime të mbulimit të shpenzimeve për shërbimet që ai do të marrë nga ZRPP-ja. Kjo llogari nuk mund të përdoret për qëllime të kompensimit të detyrimeve monetare që noteri mund të ketë ndaj ZRPP-së.

2. Noteri paraqet tek operatori i llogarisë kopje të mandatarkëtimit, me të cilën provohet derdhja në llogarinë e ZRPP-së të pagesës përkatëse.

3. Operatori i llogarisë, me marrjen e mandatarkëtimit nga përdoruesi, krediton llogarinë e këtij të fundit me vlerën e shumës së dhënë në mandatarkëtim. Veprimi i kreditimit të llogarisë së përdoruesit bëhet nga operatori i llogarisë, sa herë që nga përdoruesi paraqitet një mandatarkëtimi i ri.

#### Neni 8

### **Shërbimet *on-line* të ofruara nga ZRPP-ja**

1. ZRPP-ja ofron për noterët këto shërbime *on-line*:

a) konsultimin e kartelës dhe të dhënave të tjera të pasurisë së paluajtshme;

b) dhënien e informacionit zyrtar të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për individët dhe institucionet.

2. Për shërbimin e përshkruar në germën “a” të pikës 1 të këtij neni, noteri klikon në rubrikën përkatëse të pasurisë së paluajtshme për të cilën kërkohet shërbimi dhe ka mundësinë të shohë të dhënat e kartelës së pasurisë dhe/ose dokumentet e skanuara të referencave përkatëse, që vërtetojnë të dhënat e kartelës dhe hartës treguese të regjistrimit.

3. Për shërbimin e përshkruar në germën “b” të pikës 1 të këtij neni, noteri paraqet kërkesë *on-line* tek operatori i ZRPP-së nëpërmjet klikimit në rubrikën “kërkesë për informacion të përditësuar të kartelës dhe leje veprimi” dhe operatori pasi kryen procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim, bën të mundur, për noterin, shfaqjen *on-line* të imazheve të kartelës së përditësuar të ruajtur në letër.

4. Nëse përdoruesi kërkon leje veprimi për transferimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, për të cilën u informua, operatori i ZRPP-së i jep ose jo përdoruesit lejen e veprimit, në përputhje me rregullat e punës dhe nëpërmjet sistemit OSS, njofton përdoruesin për veprimin e bërë.

#### Neni 9

### **Tarifat e shërbimeve *on-line***

1. Shërbimet *on-line* ofrohen nga ZRPP-ja kundrejt tarifave të miratuara me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, sipas propozimit të paraqitur nga bordi drejtues.

2. Pakësimi i llogarisë bëhet menjëherë, në mënyrë automatike, nga llogaria e noterit sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje dhe dokumentohet nëpërmjet pakësimit të gjendjes kontabël të llogarisë elektronike të noterit, në vlerën e tarifës së shërbimit.

3. ZRPP-ja, me kërkesë në Degën e Thesarit do të bëjë transferimin e shumave me të cilat është pakësuar llogaria elektronike e noterit, për shkak të shërbimeve të përfituara nga llogaria “Mjete në ruajtje” e noterit në Degën e Thesarit, në llogarinë përkatëse të të ardhurave të ZRPP-së.



## Neni 10

### Afatet e shërbimeve *on-line*

1. Shërbimi i përshkruar në germën “a” të pikës 1 të nenit 8 jepet *on-line* duke klikuar në rubrikën përkatëse të pasurisë së paluajtshme, për të cilën kërkohet shërbimit. Gjatë një periudhe prej 30 ditësh nga moment i klikimit të parë, noteri ka të drejtë të kontrollojë pa pagesë kartelën dhe të dhënat e tjera të pasurisë së paluajtshme.

2. Shërbimi i përshkruar në germën “b” të pikës 1 të nenit 8, jepet brenda ditës së nesërme të punës, që vjen pas ditës në të cilën është kërkuar shërbimi nga noteri.

## Neni 11

### Procedurat e ofrimit të shërbimeve *on-line*

1. Për të përfituar shërbimin e përshkruar në germën “a” të pikës 1 të nenit 8, noteri pasi të ketë marrë më parë pëlqimin e pronarit/ëve të pasurisë së paluajtshme, me klikimin në rubrikën përkatëse të pasurisë së paluajtshme, për të cilën kërkohet shërbimi, merr automatikisht shërbimin nga sistemi OSS, nëpërmjet shfaqjeve të imazheve të skanuara të kartelës dhe të të dhënave të tjera mbi pasurinë e paluajtshme, pa pasur nevojë kryerjen e ndonjë veprimi nga operatori i ZRPP-së.

2. Për të përfituar shërbimin e përshkruar në germën “b” të pikës 1 të nenit 8, noteri, pasi merr pëlqimin e pronarit të pasurisë së paluajtshme, i kërkon ZVRPP-së, nëpërmjet klikimit në rubrikën “Kërkesë për informacion të përditësuar të kartelës dhe leje veprimi”, ofrimin e këtij shërbimi. Kërkesa e paraqitur nga noteri do të shfaqet automatikisht para operatorit të ZRPP-së, i cili është ngarkuar me plotësimin e kërkesave për pasuritë e ndodhura në zona kadastrale ku ndodhet pasuria objekt kërkesë.

3. Brenda ditës së nesërme të punës, nga dita e marrjes së kërkesës, sipas paragrafit 2 të këtij neni, operatori i ZRPP-së verifikon:

a) nëse për pasurinë objekt kërkesë është paraqitur dhe është duke u trajtuar ndonjë kërkesë tjetër për shërbim nga ZRPP-ja, që mund të sillte ndryshimin e gjendjes së ndonjërit nga seksionet e kartelës së pasurisë dhe që bëjnë të pamundur tjetërsimin e pasurisë;

b) nëse për pasurinë objekt kërkesë, në zyrën e protokoll-arkivit në ZRPP është paraqitur ndonjë akt i organeve të tjera, regjistrimi i të cilit do të passillte kufizime në të drejtën e tjetërsimit të pasurisë;

c) nëse për pasurinë objekt kërkesë, veprimet mbi pasurinë janë të kufizuara, bazuar në një akt të regjistruerit të nxjerrë në përputhje me nenin 59 dhe paragrafin 2 të nenit 75 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” apo organeve të tjera sipas ligjit;

ç) nëse për pasurinë objekt kërkesë, veprimet mbi pasurinë janë të kushtëzuara nga dhënia e pëlqimit nga një subjekt i tretë, i ndryshëm nga pronari i pasurisë;

d) bën të mundur, nëpërmjet fotografimit të kartelës manuale të pasurisë përkatëse, përgatitjen e imazhit të kartelës dhe e dërgon atë nëpërmjet sistemit IPS të ZRPP-së, në sistemin elektronik të pasurive të paluajtshme, në mënyrë që të jetë e aksesueshme nga noteri.

## Neni 12

### Procedura pas verifikimit të kërkesës

1. Menjëherë pas kryerjes së procedurës së parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, operatori i ZRPP-së, në varësi të rezultatit të verifikimit të bërë, procedon si vijon:

a) në rast të konstatimit të ekzistencës së ndonjërit nga kërkesat apo kufizimet e përmendura në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të paragrafit 3 të këtij neni, i kthen përgjigje përdoruesit nëpërmjet klikimit në rubrikën e statusit të plotësimit të kërkesës “anuluar”, duke bërë dhe komentet përkatëse. Në këtë rast përdoruesi, nuk procedon me hartimin e kontratës së tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme.

b) në rast të konstatimit të ekzistencës së kushteve të përmendura në shkronjën “ç” të paragrafit 3 të këtij neni, i kthen përgjigje përdoruesit, nëpërmjet klikimit në rubrikën e statusit të plotësimit të kërkesës “leje veprimi me kusht”, duke bërë dhe komentet përkatëse mbi kushtin. Në këtë rast noteri procedon me hartimin e kontratës së kalimit të pronësisë, pasi nga pronari të provohet dhënia e pëlqimit për transferimin nga subjekti përkatës.

c) Në rast të moskonstatimit të asnjërës nga rrethanat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni, i kthen përgjigje përdoruesit, nëpërmjet klikimit në rubrikën e statusit të plotësimit të kërkesës “sukses”. Në këtë rast përdoruesi procedon me hartimin e kontratës së tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme.

ç) në rastet e shkronjave “b” dhe “c” të këtij paragrafi, për pasurinë objekt kërkesë të përdoruesit nga sistemi rezervohet e drejta e tjetërsimit për një periudhë prej 30 ditësh kalendarike, nga data e dhënies së përgjigjes “sukses” apo “leje veprimi me kusht”. Operatori i ZVRPP-së kujdeset që në kartelën manuale të pasurisë, për të cilën është rezervuar e drejta e tjetërsimit, të pasqyrohen shënimet e rezervimit dhe afati. Pas kalimit të afatit të rezervimit, sistemi OSS, automatikisht shuan këtë të drejtë. Në kartelën manuale, operatori i ZRPP-së, heq shënimin e rezervimit me kalimin e afatit 30-ditor. Gjatë periudhës së rezervimit, asnjë akt tjetër i hartuar pas momentit të rezervimit dhe për të cilin është paraqitur një kërkesë për regjistrim, nuk do të regjistrohet. Në rast se akti noterial i tjetërsimit të pasurisë, paraqitet për regjistrim dhe regjistrimi kryhet pa përfunduar ende afati 30-ditor i rezervimit, operatori i ZVRPP-së liron pasurinë nga rezervimi dhe e kalon në statusin e procesit të kërkesës “mbyllur”. Në këtë rast, operatori i ZRPP-së heq edhe shënimin e rezervimit në kartelën manuale të pasurisë.

2. Për kryerjen e procedurës së parashikuar në këtë nen, operatori i ZRPP-së ndihmohet nga punonjësit e ZRPP-së, pjesë e strukturës së zonës përkatëse të punës, të cilët i ngarkon me kryerjen e verifikimeve përkatëse dhe përgatitjen e imazheve të kartelës manuale. Rezultatet e verifikimit të kryera nga punonjësi i ngarkuar, fiksohen në një dokument/regjistër, i cili përmban të dhëna për pasurinë e verifikuar, datën dhe orën e verifikimit, rezultatin e verifikimit, si dhe nënshkrimin nga punonjësi që kreu verifikimin.

Në çdo rast, dërgimi i imazhit të kartelës manuale nëpërmjet sistemit IPS në sistemin elektronik të pasurive të paluajtshme, dhënia e përgjigjeve *on-line* për noterët, kryerja dhe heqja e shënimeve të rezervimit në kartelën manuale, lirimi i pasurisë nga rezervimi dhe kalimi në statusin e procesit të kërkesës “mbyllur”, kryhet nga operatori i ZRPP-së.

3. Regjistruesi i ZRPP-së përkatëse ka detyrimin të verifikojë ecurinë e procesit të trajtimit të kërkesave, respektimin e procedurës dhe të raportojë te drejtuesit e vet.

### Neni 13

#### **Të drejtat dhe detyrimet e noterit**

1. Noterët për aksesimin dhe marrjen e shërbimeve të kërkuara nëpërmjet këtij sistemi, kanë këto detyrime:

a) të kryejnë regjistrimin si përdorues dhe të hapin llogarinë e përdoruesit sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje;

b) të paguajnë tarifa për shërbimet e kërkuara;

c) të përgjigjen për çdo kërkesë apo pretendim të pronarit të pasurisë së paluajtshme kundrejt ZRPP-së, për dëme të shkaktuara, për shkak të mosrespektimit nga noterit të nenit 54 të ligjit nr. 7889, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar.

2. Noterët, për aksesimin dhe marrjen e shërbimeve të kërkuara nëpërmjet këtij sistemi, kanë këto të drejta:

a) të pajisen me *user name* dhe *password*;

b) të ndryshojnë *password*-in e marrë pasi ka hyrë në sistem për herë të parë;





- c) të logohen në sistemin OSS pa pagesë;
- ç) të paraqesin kërkesa për përfitimin e shërbimeve dhe të kërkojnë ofrimin e shërbimit sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në këtë rregullore;
- d) të marrin informacionin e duhur për shërbimin e kërkuar;
- e) të paraqesin ankesë, në rast të shkeljes së detyrimeve nga punonjësit e ZRPP-së.

#### Neni 14

#### **Operatori i llogarisë**

1. Operatori i llogarisë ka detyrimin të hapë llogarinë e përdoruesi për noterin, menjëherë pasi ka administruar nga ky i fundit kopje të mandatarkëtimit, sipas kësaj rregulloreje.
2. Operatori i llogarisë, sa herë që nga noteri paraqitet një mandatarkëtim, ka detyrimin të kreditojë llogarinë e këtij të fundit me vlerën e shumës së dhënë në mandatarkëtim.
3. Operatori i llogarisë njofton administratorin e sistemit për pamundësinë e ofrimit të shërbimeve nga sistemi për përdoruesit të cilëve u ka përfunduar krediti në llogari.
4. Operatori i llogarisë raporton me shkrim për çdo kërkesë të administratorit të sistemit lidhur me ankimet që parashtrojnë noterët në lidhje me llogarinë në raport me shërbimet e ofruara nga sistemi OSS.
5. Operatori i llogarisë, për një funksionim sa më të mirë të sistemit, bashkëpunon e koordinon me administratorin dhe kryen të gjitha detyrat e ngarkuara prej tij.
6. Operatori i llogarisë, kryen dhe paraqet në Drejtorinë Ekonomike të ZRPP-së, kopje të mandatarkëtimeve të përdoruesve, brenda ditës së punës në të cilën ato janë paraqitur.
7. Operatori i llogarisë, përgatit raporte javore financiare, shoqëruar me dokumentet përkatëse, në lidhje me shërbimet e ofruara nga OSS për noterët dhe të ardhurat nga këto shërbime.

#### Neni 15

#### **Operatori i ZRPP-së**

1. Operatori i ZRPP-së merr dhe trajton kërkesat për shërbime të bëra *on-line* nga noterët, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore.
2. Operatori i ZRPP-së, pas administrimit në rrugë elektronike të një kërkesë nga noteri "Për dhënien e informacionit të përditësuar të kartelës dhe leje veprimi", ka të drejtë të ngarkojë punonjësit e ZRPP-së, pjesë e strukturës së zonës përkatëse të punës, me detyrën e kryerjes së verifikimeve përkatëse, përgatitjen e imazheve të kartelës manuale.
3. Operatori i ZRPP-së ka detyrimin të trajtojë kërkesat brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore, si dhe të garantojë realizimin me cilësi të shërbimit.
4. Operatori i ZRPP-së ka detyrimin të raportojë çdo ditë te regjistruesi për kërkesat e paraqitura dhe ecurinë e trajtimit të tyre.
5. Operatori i ZRPP-së, për ankesat e paraqitura nga noteri, bashkëpunon me administratorin për zgjidhjen e trajtimit të tyre dhe bën të gjitha përpjekjet që të mos cenohen marrëdhëniet midis noterit dhe ZRPP-së.

#### Neni 16

#### **Administratori i sistemit**

1. Administratori i sistemit mirëmban dhe drejton funksionimin e sistemit.
2. Administratori i sistemit mbikëqyr procesin e pranimit, trajtimit dhe ofrimit të shërbimit nga operatorët e ZRPP-së, si dhe nënshkruan formularin tip të regjistrimit si përdorues, sipas modelit të paraqitur në aneksin 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

3. Administratori i sistemit i dorëzon noterit, *user name*-in si përdorues dhe fjalëkalimin.
4. Administratori i sistemit ka autoritetin e plotë për të shtuar dhe për të hequr çdo të dhënë nga sistemi e cila nuk është më e nevojshme.
5. Administratori i sistemit, pas njoftimit të operatorit të llogarisë, për noterët të cilëve u ka përfunduar krediti në llogari, u dërgon një njoftim elektronik këtyre të fundit për mungesën e krediteve në llogarinë e tyre në ZRPP dhe për pamundësinë e ofrimit të shërbimeve nga sistemi në të ardhmen, deri në momentin e kryerjes së pagesës së re.
6. Administratori i sistemit, trajton dhe zgjidh ankimet e administruara elektronikisht apo në formë shkresore, të noterëve në lidhje me shërbimet e kërkuara *on-line*, apo në lidhje me kreditet e tyre në raport me pagesat në OSS. Administratori për ankimet bashkërendon me operatorin e llogarisë dhe operatorin e ZRPP-së.
7. Administratori i sistemit, për funksionimin e sistemit dhe ankimet e përdoruesve, raporton periodikisht te kryeregjistruesi, të paktën një herë në javë.
8. Administratori i sistemit, për funksionimin e sistemit, është personi përgjegjës që duhet të mbajë kontaktet me mirëmbajtësin e sistemit.

### KREU III DISPOZITA TË FUNDIT

#### Neni 17 **Ankimet**

1. Noterët, në lidhje me shërbimet e kërkuara *on-line* apo në lidhje me kreditet e tyre në raport me pagesat e bëra automatikisht nga sistemi OSS, mund të paraqesin ankim tek administrator në mënyrë elektronike apo në formë shkresore.
2. Ankimi duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme mbi problemin e evidentuar nga noteri.

#### Neni 18 **Plotësimi i informacionit**

Për çdo rast që administratori vlerëson se ankimi është i paplotë dhe nuk përmban të dhënat e mjaftueshme për të përcaktuar objektin e tyre apo për të bërë të mundur shqyrtimin e pretendimit të paraqitur, i kërkon ankimuesit në rrugë elektronike, plotësimin e ankesës.

#### Neni 19 **Zgjidhja e problemit dhe afatet**

1. Pas njohjes me ankimet, administratori i paraqet ato para kryeregjistruesit, i cili, në varësi të problemit që ato parashtrajnë, i delegon për trajtim te drejtoritë, sektorët apo punonjësit e ngarkuar prej tij, të cilët duhet të verifikojnë dhe t'i kthejnë përgjigje zyrtare ankimuesit për pretendimet e tij.
2. Në rastet kur çështja e paraqitur ka të bëjë me ankim ndaj trajtimit të aplikimit të një shërbimi në ZRPP, të ndryshëm nga shërbimet e ofruara sipas kësaj rregulloreje, drejtoritë, sektorët apo punonjësit e ngarkuar në trajtimin e çështjes, e orientojnë ankuesin të dërgojë në ZRPP një ankim në përputhje me nenin 66 të Kodit të Procedurave Administrative.



Neni 20  
**Dispozitë tranzitore**

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje që i referohen regjistrimit elektronik të pasurive të paluajtshme, do të konsiderohen se i referohen arkivës digjitale që është krijuar pranë ZRPP-së në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, deri në momentin e krijimit dhe funksionimit të regjistrimit elektronik të pasurive të paluajtshme.

2. Deri në miratimin e udhëzimit të përbashkët për përcaktimin e tarifave të shërbimit, sipas përcaktimit të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe të kësaj rregulloreje, ZRPP-ja do të aplikojë tarifat e shërbimit të parashikuara në vendimin nr. 713, datë 20.10.2011 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, duke i shtuar kësaj tarife edhe vlerën e tarifës së pullës për shërbimin përkatës.

Neni 21  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

ANEKSI 1  
**FORMULAR TIP I REGJISTRIMIT TË PËRDORUESIT**

Emri i përdoruesit	
Mbiemri i përdoruesit	
Dhoma e përdoruesit	
Adresa e përdoruesit	
Email-i i përdoruesit	
NTUIS	
Telefon zyre	
Telefon mobile	
Fjalëkalimi	
User Name	

Përdoruesi

Administratori

**VENDIM**  
**Nr. 36, datë 5.6.2012**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Ploçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	Anëtar i “ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare e “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datë 29.03.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 5 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Qazim Kokoshi, i përfaqësuar nga avokat Agron Lamaj, me prokurë të posaçme.

**SUBJEKTI I INTERESUAR:** Lutfi Dokushi, i përfaqësuar nga avokat Dilaver Rexhepaj dhe avokate Enekelejda Kambo, me prokurë të posaçme.

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, e përfaqësuar nga Arjan Halilaj, me autorizim.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si antikushtetues, i vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 324, datë 16.06.2011; i vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 1705, datë 28.10.2008, si dhe i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 1389, datë 19.02.2008.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 3, 4, 42, 43, 131/f, 132, 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Admir Thanza, përfaqësuesin e kërkuesit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, i cili la zgjidhjen e çështjes në çmim të Gjykatës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar Lutfi Dokushi, e cila kërkoi rrëzimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I

#### ***Rrethanat e çështjes***

1. Mbështetur në aktet bashkëngjitur kërkesës rezulton se Qazim Kokoshi (kërkuesi) me kontratën nr. 2833/360, datë 12.12.2003, ka blerë një pronë. Kjo pronë rezultonte e shitur që në vitin 1997 në favor të subjektit të interesuar Lutfi Dokushi, i cili iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me një padi me objekt shpalljen absolutisht të pavlefshme të kontratës së shitjes të vitit 2003, të sipërpërmendur dhe fshirjen e regjistrimeve përkatëse pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Kjo Gjykatë, me vendimin nr. 1389, datë 19.02.2008, vendosi pranimin e padisë.

2. Kundër këtij vendimi, avokate H. B., në emër të kërkuesit, paraqiti një ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Kjo Gjykatë, me vendimin nr. 1705, datë 28.10.2008, vlerësoi se nuk duhej t'i hynte shqyrtimit të themelit të çështjes me arsyetimin se avokate H. B., nuk ishte e pajisur me prokurë noteriale në bazë të së cilës ajo mund të gëzonte tagrat ligjore për t'u legjitimuar në bërjen e ankimit në emër të kërkuesit. Rrjedhimisht, në bazë të nenit 450/ç të Kodit të Procedurës Civile, ajo vendosi mospranimin e ankimit.

3. Kundër vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Tiranë, kërkuesi ushtroi të drejtën e rekursit pranë Gjykatës së Lartë. Kjo Gjykatë, me vendimin nr. 324, datë 16.06.2011, pasi konstatoi se e drejta për të bërë ankim pranë Gjykatës së Apelit nuk i ishte deleguar avokatit as me prokurë dhe as me gojë përpara Gjykatës së Rrethit Tiranë, vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë me arsyetimin se dispozitat e Kodit Civil dhe atij të Procedurës Civile kërkojnë detyrimisht që tagrat e përfaqësimit, që i delegohen një avokati të parashikohen shprehimisht në një prokurë noteriale ose t'i jepen shprehimisht gjatë gjykimit.

#### II

#### ***Pretendimet e palëve parashtruar Gjykatës Kushtetuese***

4. *Kërkuesi* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim Gjykata), duke pretenduar se me vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 324, datë 16.06.2011, vendimin e Gjykatës së



Apelit Tiranë nr. 1705, datë 28.10.2008, si dhe me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 1389, datë 19.02.2008 (vendimet objekt kërkesë), ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht, kërkuesi pretendon se:

4.1 Është cenuar e drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor, pasi Gjykata e Apelit, edhe pse e ka pranuar ankimin, nuk e ka shqyrtuar atë në themel. Gjykata e Apelit ka mbështetur vendimin e saj mbi një arsyetim që bie në kundërshtim me parimin e të drejtës së mbrojtjes dhe përfaqësimit. Për shkak të statusit të veçantë që gëzon avokati, prezumohet se ai ka mandatin e klientit të tij për sa kohë një fakt i tillë nuk kundërshtohet në bazë të nenit 13/2 të Kodit të Procedurës Civile.

Sipas tij, në bazë të nenit 461 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata e Apelit verifikon vetëm paraqitjen e rregullt të palëve, por jo legjitimitetin e tyre, i cili kontrollohet nga Gjykata e Rrethit në bazë të nenit 450 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

Gjykata duhej të kishte zbatuar nenin 455/b të Kodit të Procedurës Civile dhe të lejonte një afat 5-ditor për të ndrequr të metat.

Gjykata e Apelit, edhe pse ka ndjekur procedurën e parashikuar në nenin 460 të KPC-së, nuk ka marrë një nga vendimet e nenit 466 të KPC-së.

Është shkelur parimi i barazisë së armëve, pasi kërkuesit nuk iu dha mundësia e mbrojtjes ndaj pretendimit që parashtrroi Gjykata e Apelit për mospranimin e ankimit.

4.2 Vendimet objekt kërkesë janë dhënë në shkelje të parimit të kontradiktoritetit. Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë, në seancën e fundit (datë 19.02.2008), ka refuzuar kërkesën e paraqitur me shkrim nga kërkuesi për të shtyrë seancën, pasi avokatja e tij nuk mund të ishte e pranishme për shkak të një gjykimi në Gjykatën e Lartë. Për shkak të këtij veprimi, vendimi është marrë vetëm mbi pretendimin e palës tjetër, pasi kërkuesi është gjykuar në mungesë pa iu krijuar mundësia për t'u dëgjuar dhe mbrojtur.

5. *Subjekti i interesuar, Lutfi Dokushi*, pretendoi me shkrim dhe në seancë plenare se:

5.1 Ankimi i paraqitur nga kërkuesi pranë Gjykatës së Apelit është në kundërshtim me kërkesat e nenit 453 të Kodit të Procedurës Civile për arsye se: së pari, kërkuesi nuk ka caktuar as me prokurë dhe as me deklaram një përfaqësues për të bërë ankim dhe, së dyti, prokura e vitit 2006 që ai ka paraqitur nuk është pranuar me vendim të ndërmjetëm nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

Edhe pse avokatja është pajisur me prokurë një ditë përpara seancës pranë Gjykatës së Apelit dhe kërkuesi ka qenë prezent në këtë seancë, kjo gjykatë, me të drejtë, vendosi të mos pranojë të shqyrtojë ankimin, pasi, sipas kërkesave të neneve 443/I, 444 dhe 450/a të Kodit të Procedurës Civile, ankimi është i papranueshëm nëse nuk është ushtruar brenda afatit 15-ditor.

Gjithashtu, Gjykata e Apelit nuk kishte pse t'i linte kërkuesit një afat 5-ditor për të plotësuar të metat e ankimit, pasi ai e ka pasur këtë afat që në momentin e depozitimit të ankimit.

Kërkuesi është neglizhent, pasi nuk është paraqitur as në gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe as në gjykimin e një padie tjetër të ngritur prej tij, kundër subjektit të interesuar, pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, e cila rrjedhimisht është pushuar me vendimin nr. 10572, datë 21.12.2011.

Gjykatat duhet të kenë parasysh edhe të drejtën e subjektit të interesuar për një proces të rregullt ligjor. Kërkuesit i është lënë mundësia për të mbrojtur të drejtat e tij, por kjo mundësi nuk mund të lihet në pafundësi në dëm të palëve të tjera.

5.2 Pretendimi i dytë i kërkuesit është i pambështetur në ligj, për arsye se rezulton nga procesverbalet e seancave gjyqësore që gjykimi është shtyrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për t'i dhënë kohë kërkuesit për të caktuar një avokat mbrojtës. Megjithatë, ai nuk e ka caktuar një të tillë me prokurë dhe ka refuzuar ta caktojë me deklaram përpara saj. Këto veprime të kërkuesit bëheshin në mënyrë të qëllimshme për të zvarritur procesin.

### III

**1. Mbi pretendimet për cenimin e të drejtës së ankimit në funksion të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit) nga interpretimi i gabuar i ligjit**

6. Kërkuesi parashtron përpara Gjykatës Kushtetuese se Gjykata e Apelit Tiranë ka bërë një interpretim të gabuar të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, i cili, sipas tij, ka rezultuar në cenimin e të drejtës së tij themelore të ankimit kundër një vendimi gjyqësor dhe të së drejtës së aksesit në gjykatë.

7. Në shqyrtimin e këtij pretendimi, Gjykata Kushtetuese vlerëson të nevojshme të përsërisë qëndrimin e saj konstant se, në kuadër të kontrollit që ajo ushtron në zbatim të nenit 131/f të Kushtetutës, çështjet e interpretimit të ligjit hyjnë në juridiksionin kushtetues vetëm nëse dhe për aq sa ky interpretim ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

8. Në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka pranuar, në mënyrë të vazhdueshme, se ajo ndërhyr në ato raste kur përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizuar ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 dhe 131, shkronja "F" të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 14, datë 03.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në rrethanat konkrete të çështjes, Gjykata vlerëson se duhet të shqyrtojë interpretimin e bërë nga Gjykata e Apelit Tiranë vetëm për aq sa ky interpretim mund të ketë cenuar të drejtën e kërkuesit për ankim kundër një vendimi gjyqësor dhe të drejtën për akses në gjykatë.

**a) Mbi pretendimin se është cenuar e drejta e ankimit:**

10. Gjykata Kushtetuese konsideron se Kushtetuta, në vijim të garancive të ofruara nga neni 42 i saj, parashikon në nenin 43 se çdokush ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. E drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor është një nga të drejtat themelore të individit, e cila, mbi bazën e parashikimit kushtetues, gjen zbatim edhe në dispozitat materiale e procedurale konkrete. Kjo e drejtë duhet kuptuar si një mundësi e çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj, sipas kuadrit ligjor në fuqi (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë nr. 14, datë 05.07.2005 dhe nr. 5, datë 06.03.2009*).

11. Gjykata Kushtetuese vëren se Kodi i Procedurës Civile, neni 442, parashikon ankimin si një mjet për të kundërshtuar përpara një gjykate më të lartë një vendim gjyqësor. Në zbatim të nenit 442/a të KPC-së, rezulton se mjete i ankimit i përket një pale ose një pjesëmarrësi në proces dhe ushtrohet nga ata për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi kishte mjetin procedural të ankimit për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

12. Bazuar në vetë parashtrimet e kërkuesit dhe në aktet bashkëngjitur kërkesës, rezulton se ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 1389, datë 19.02.2008, është bërë ankim në emër të kërkuesit. Ankimi nuk përmbante nënshkrimin e kërkuesit, por vetëm të avokates H. B., e cila vepronte, sipas kërkuesit, në bazë të një prokure të vitit 2006. Gjykata Kushtetuese, referuar tagrave të prokurës së mësipërme, vlerëson se tagrat e përfaqësimit të deleguara nga kërkuesi kanë lidhje me një gjykim tjetër dhe nuk përputhen me objektin e gjyqimit të rastit konkret. Ankimi është depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datë 04.03.2008. Kjo gjykatë, pasi e ka



kthyer ankimin në datën 13.03.2008 për plotësimin e të metave, e ka pranuar atë dhe Gjykata e Apelit Tiranë është vënë në lëvizje me këtë mjet. Rezulton nga aktet bashkëngjitur kërkesës se Gjykata e Apelit Tiranë ka caktuar një seancë për të shqyrtuar ankimin. Një ditë përpara seancës kërkuesi ka bërë një prokurë noteriale për t'i dhënë tagër avokates H. B., që ta përfaqësojë në mbrojtjen e çështjes përpara kësaj gjykate. Në seancë, mbështetur në vetë parashtrimet e tij (fq. 5 e kërkesës), kërkuesi së bashku me avokaten e tij kanë qenë të pranishëm.

13. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se mjeti për t'u ankuar ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 1389, datë 19.02.2008 ekzistonte, ishte në dispozicion dhe kërkuesi parashtron se e ka ushtruar atë për të vënë në lëvizje një gjykatë më të lartë për shqyrtimin e çështjes së tij.

14. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimi se është cenuar e drejta e ankimit është i pabazuar dhe si i tillë nuk mund të pranohet.

**b) Mbi pretendimin se është cenuar e drejta e aksesit:**

15. Gjykata Kushtetuese vëren se kërkuesi parashtron përpara saj se Gjykata e Apelit i ka cenuar atij të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi duke keqinterpretuar ligjin për sa u takon rregullave për përfaqësimin, ka refuzuar të shqyrtojë në themel ankimin e tij.

16. Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkuesi, në mënyrë të nënkuptuar, me këtë pretendim i referohet cenimit të së drejtës për të pasur akses në gjykatë.

17. Gjykata Kushtetuese thekson se mohimi i të drejtës së aksesit, d.m.th. i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare nga ajo lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane, si dhe i trajtuar gjerësisht nga jurisprudenca e kësaj gjykate (*shih në vendimin nr. 7, datë 11.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata Kushtetuese rithekson se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimin nr. 14, datë 03.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. E drejta e aksesit në gjykatë mund t'u nënshtrohet kufizimeve deri në atë masë sa ato të mos cenojnë thelbin e kësaj të drejte. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i të drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar Gjykatës (*shih vendimin nr. 18, datë 08.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit Tiranë ka refuzuar të shqyrtojë në themel pretendimet e paraqitura në ankim, me arsyetimin se në momentin e bërjes së tij, ankimi ishte nënshkruar nga një përfaqësues pa tagra.

20. Duke konsideruar rëndësinë thelbësore të mjetit të ankimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe në koherencë me parashikimet e nenit 442/a të KPC-së, ligjvënësi, në nenin 453 të KPC-së, ka parashikuar se ankimi duhet të nënshkruhet "*nga vetë pala, avokati ose përfaqësuesi me prokurë*". Gjykata vëren se ligjvënësi në këtë dispozitë ka kufizuar të drejtën për të bërë ankim në tri raste. Së pari, ankimi mund të bëhet nga një palë personalisht. Së dyti, mund të bëhet nga avokati i një pale, i cili në zbatim të nenit 96 të KPC-së, duhet të gëzojë tagrat për të përfaqësuar palën në saje të një prokure të bërë me shkrim sipas dispozitave të Kodit Civil (KC) ose me deklaram të palës së përfaqësuar përpara gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjen. Së treti, ankimi mund të bëhet nga përfaqësues me prokurë, që nuk janë avokatë, por që listohen në parashikimet e nenit 96 të KPC-së.

21. Gjykata Kushtetuese vëren, gjithashtu, se delegimi i tagrave në raste specifike prezumohet nga ligji. Në të drejtën shqiptare, neni 222 i Kodit të Familjes parashikon, në lidhje me

ushtrimin e përgjegjesisë prindërore, se një prind prezumohet se gëzon tagra nga prindi tjetër për të kryer një veprim të zakonshëm me të tretë.

22. Gjykata vëren se një arsyetim i ngjashëm i shtrohet për shqyrtim nga kërkuesi, i cili shprehet, në thelb, se delegimi i të drejtës për ankim një avokati nga klienti i tij prezumohet. Gjykata vlerëson se prezumimi, nga vetë natyra e tij, përbën një përjashtim ndaj një rregulli të përgjithshëm, prandaj i takon palës që pretendon ekzistencën e tij që ta provojë atë. Gjykata vëren se kërkuesi nuk parashtron asnjë dispozitë ligjore materiale mbi të cilën të mbështesë ekzistencën e këtij prezumimi. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se ky arsyetim nuk mund të shërbejë si bazë për të pranuar pretendimin e kërkuesit.

23. Gjithashtu, kërkuesi shtron për shqyrtim përpara Gjykatës Kushtetuese arsyetimin se Gjykata e Apelit Tiranë, në momentin që ka konstatuar se ankimi është bërë nga një përfaqësues pa tagra, duhej t'i kishte caktuar kërkuesit një afat pesëditor për të ndrequr këtë të metë.

24. Vërehet se arsyetimi i kërkuesit gjen mbështetje në nenin 78 të Kodit Civil, sipas së cilit një veprim që është kryer pa tagra mund të miratohet më vonë nga personi në emër të të cilit ai është kryer. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kjo dispozitë përmban një rregull të përgjithshëm, i cili në përputhje me parimin *lex specialia generalibus derogant*, zbatohet vetëm për atë sa norma specifike nuk i bëjnë përjashtim. Referuar nenit 97, që përfshihet në pjesën e parë të Kodit të Procedurës Civile, në kreun e veçantë të emërtuar “Përfaqësuesit”, Gjykata vëren se ky nen parashikon se aktet që sjellin disponim të një të drejte mund të kryhen vetëm në rast se përfaqësuesi ka fituar tagër në mënyrë të shprehur.

25. Gjykata vlerëson se ushtrimi i mjetit të ankimit është një mjet shumë i rëndësishëm procedural. Ky mjet, përveçse përbën ushtrimin e një të drejte themelore, sjell pasoja të rënda si shtyrja në kohë e momentit të marrjes së një vendimi formë të prerë dhe krijon mundësinë e ndryshimit, në favor ose në dëm të palëve, të një vendimi. Më tej, në zbatim të nenit 459 të KPC-së, Gjykata vëren se bërja e ankimit sjell rënien në dekadencë të disa kërkesave, që nuk pasqyrohen në të. Për pasojë, është e qartë se e drejta për të bërë ankim ndaj një vendimi gjyqësor përbën disponim të një të drejte.

26. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se dispozitat specifike të nenit 97 të KPC-së kërkojnë që delegimi te një përfaqësues i tagrave për të bërë ankim ndaj një vendimi gjyqësor, duhet bërë detyrimisht në mënyrë të shprehur. Gjykata, mbështetur në dosjen gjyqësore, vëren se edhe pse kërkuesi, gjatë gjykimit të çështjes pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka marrë pjesë në disa seanca gjyqësore, nuk rezulton që të ketë kërkuar të shprehet apo të jetë shprehur se i delegonte, me deklaram përpara gjykatës, të drejtën për të bërë ankim avokates së tij. Gjithashtu, rezulton se kërkuesi nuk sjell provën se i ka deleguar këto tagra me akt noterial përpara momentit të bërjes së ankimit. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se me të drejtë Gjykata e Apelit Tiranë ka vlerësuar se ankimi është bërë nga një përfaqësues pa tagra. Gjykata e Apelit Tiranë nuk mund të caktonte një afat për korrigjimin e kësaj të metë, pasi kjo e metë, në përputhje me parashikimet e nenit 97 të KPC-së të sipërpërmendur, nuk mund të korrigjohej nëpërmjet konfirmimit të mëvonshëm nga kërkuesi.

27. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se e drejta e ankimit në funksion të së drejtës së aksesit nuk i është cenuar kërkuesit në thelb, pasi mosshqyrtimi i ankimit të kërkuesit ka ardhur si pasojë e drejtpërdrejtë e mosveprimit të tij për të deleguar te përfaqësuesi tagrat e nevojshme në kohën e duhur. Gjykata vëren se kërkuesi nuk sjell asnjë pretendim apo provë për të justifikuar objektivisht këtë mosveprim.

## **2. Mbi pretendimin e cenimit të parimit të kontradiktoritetit**

28. Kërkuesi parashtron se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet refuzimit të shtyrjes së seancës së datës 19.02.2008, në mënyrë që ai të mund të mbrohej me një avokat, i ka cenuar të drejtën themelore për t'u mbrojtur dhe për të pasur një proces kontradiktor.





29. Gjykata Kushtetuese vlerëson se në shqyrtimin e këtij pretendimi ajo duhet paraprakisht të verifikojë që kërkuesi legjitimohet, në kuptim të nenit 131 shkronja “f” të Kushtetutës.

30. Në përputhje me dispozitën e mësipërme të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese bën “*gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave*”.

31. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka vlerësuar se shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. (*Vendimet nr. 6, datë 31.03.2006 dhe nr. 27, datë 20.06.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve të ankimit është trajtuar edhe nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, e cila në çështjen “Qufaj kundër Shqipërisë” është shprehur se ankuesit duhet të përdorin mjetet ligjore, që sipas sistemit juridik të brendshëm, janë zakonisht në dispozicion të palëve dhe të mjaftueshme për të vënë në vend të drejtat e shkelura.

32. Shterimi i mjeteve është parakusht që duhet përmbushur nga ankuesi, i cili, para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimin 21, datë 03.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Gjykata vëren se kërkuesi kishte në dispozicion mjetin e ankimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, për të vënë në vend të drejtën që pretendon se i është shkelur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 1389, datë 19.02.2008.

34. Në përputhje me qëndrimin e mbajtur në shqyrtimin e pretendimit të parë, Gjykata vlerëson se kërkuesi, për shkaqe që mund t’i atribuohen vetëm atij, nuk e ka ushtruar mjetin e ankimit në mënyrën e përcaktuar nga ligjet në fuqi. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk e ka shteruar këtë mjet dhe për pasojë nuk legjitimohet, në kuptim të nenit 134 shkronja “f”, për të paraqitur pretendimin e tij të dytë përpara Gjykatës Kushtetuese.

35. Gjykata Kushtetuese përfundimisht vlerëson se kërkesa duhet rrëzuar, pasi kërkuesi nuk legjitimohet për një pjesë të pretendimeve, ndërsa pjesa tjetër është e pabazuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.  
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Petrit Pllloçi, Admir Thanza, Fatmir Hoxha.

#### KËRKESË

Shtetasi Klodian Tare, i biri i Misirit dhe i Lulzimes, i datëlindjes 11.5.1991, banues në fshatin Lybesh, komuna Vërtop Berat, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, shpalljen të zhdukur të shtetasit Misir Orhan Tare.

KËRKUESI  
**Klodian Tare**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 21.6.2012  
Doli nga shtypi më 22.6.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 30 lekë